



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

Numri i lëndës: 2021:027763

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05574891

C-III-24-0031

08.04.2024

Paditës:

1. N.SH. "Vreshtaria" Prizren e përfaqësuar nga AKP-ës

Të paditur

1. H(A) K
2. Zh (O) T

Për: **Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) sipas gjyqtarit Murat Hulaj, pas vlerësimit të kompetencës lëndore- të deleguar nga Gjykata Themelore Prizren, jashtë seancës nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

1. **Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion lëndor mbi propozimin e propozuesit dhe kundërpropozusve për të vendosur në procedurë jo-kontestimore për ndarje fizike.**
2. **Lënda me te gjitha shkresat i kthehet Gjykatës Themelore në Prizren, si gjykatë kompetente për shqyrtimin e propozimit të propozuesit dhe kundërpropozusve që të vazhdoj se proceduari në lëndën CN.nr. 76/2021, pasi që Aktvendimi të bëhet i plotfuqishëm.**
3. **Nuk caktohet taksa gjyqësore**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më dt.22.02.2024 regjistruar, përderisa ne zyre me dt. 26.03.2024, Dhoma e Posaçme ka pranuar Aktvendimet e Gjykatës Themelore të Prizren, CN.nr.76/2021 te dt. 09.11.2023, me të cilat Gjykata Themelore-Prizren e ka shpallur veten jo-kompetente në pikëpamje lëndore në çështjen juridike- jo-kontestimore dhe lëndën e ka transferuar në Dhomën e Posaçme duke e konsideruar si kompetente për të vendosur për propozimin e propozuesit dhe kundërpropozusve si bashkëpronar për ndarjen e palujtëshmerisë se evidentuar si njësia kadastrale P-..., Zona Kadastral-S e P, Zyra Kadastrale Prizren (përshkruar më gjerësisht si ne propozim e parashtruar

nga AKP-Zyra Regjionale Prizren si administruese për N.SH "Vreshtaria"- Prizren dhe kundërpropozusve: 1) H(A) K dhe 2) Zh (O) T me adresë të panjohur.

Arsyetimi ligjor

Neni 26 i Ligjit për Gjykatat e Rregullta (*Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës*, nr. 21/78) në paragrafin 14 përcakton se gjykatat komunale/tani Themelore janë kompetente, "për të vendosur për procedurën e trashëgimisë, procedurën e përmbarimit, procedurën për regjistrimin e të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme, në rastet e ndarjes fizike, rregullimin e çështjes së kufijve, vërtetimin e transkriptove, dorëshkrimeve dhe nënshkrimeve, si dhe çështjeve tjera jashtë-kontestimore të cilat janë, me ligj të vëna në juridiksionin e gjykatave të rregullta. Ky ligj është shfuqizuar me nenin 42.1 të ligjit për gjykatat i cili ka hyrë në fuqi për sa i përket kësaj dispozite me 1 janar 2013.

Tani neni 11 i Ligjit për Gjykatat Nr. 03/L-199, që është në fuqi që nga 01 Janari 2013, thotë se gjykatat themelore kanë kompetencë si gjykata të shkallës së parë.

Sipas nenit 4 të Ligjit 03/L-007 për procedurën jo-kontestimore, gjykatat e shkallës së parë kanë juridiksion në procedurën e jo-kontestimore bazuar ne propozimin e palëve qofshin persona fizik apo juridik të cilët e iniciojnë procedurën bazuar ne propozimet e palëve. Propozimi për ndarje fizike edhe ne aspektin lëndor dhe në aspektin territorial i përket Gjykatës te secilës edhe i ka shkuar propozimi për ndarje fizike e jo Dhomës se Posaçme ashtu siç është menduar nga gjykata-gjyqtarja e cila edhe e ka dërguar lëndën duke menduar se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS) është kompetente për të vendosur ne procedurë jashtë-kontestimore. Kërkesa për ekzekutim-ndarje fizike nuk është njëra nga çështjet me të cilat vishet ekskluzivisht juridiksioni në nenin 5 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme.

Neni 5 përcakton saktë dhe qartë në mënyrë të qartë dhe të saktë se cilat janë kompetencat edhe juridiksioni i Dhomës se Posaçme te Gjykatës Supreme , dhe duke vlerësuar shkresat e lëndës gjënë se nuk ka ndonjë normim ne kuadër te këtij neni, përkatësisht te paragrafëve dhe nënë paragrafëve normues që i përkasin dhe e veshin me një kompetencë të tillë qe të zhvilloj procedurë jashtë kontestimore te pretenduar nga gjykata dërguese ngase kjo procedurë zhvillohet ne kuadër te gjykatave të rregullta themelore.

Dhoma e Posaçme ka vlerësuar se propozimi i AKP-ës adresuar Gjykatës Themelore është i drejtë dhe i ligjshëm dhe mbi këtë vlerëson se mbi rrethanat e cekur lënda me të gjitha shkresat i dërgohet Gjykatës Themelore në Prizren për të vazhduar me procedurën jashtë-kontestimore, pasi qe ky Aktvendim të bëhet i plotfuqishëm.

Shpenzimet gjyqësore

Nuk ka nevojë të marrim ndonjë vendim mbi shpenzimet e procedurës, pasi qe te njëjtat janë deponuar paraprakisht ne shumë prej 30.00 Euro nga parashtruesi i propozimit.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi palët e pakënaqura mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Në rast se palët brenda 15 ditëve nuk e ushtrojnë drejtën e ankimit sipas udhëzimit për në Kolegjin e Apelit ndaj këtij aktvendimi, dosja origjinale me të gjitha shkresat do të dërgohet në Gjykatën Themelore në Prizren pasi që aktvendimi të bëhet i plotfuqishëm, përderisa një kopje e dosjes do arhivohet në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS).

Gjyqtari,
Murat Hulaj